



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakt i raportit përfundimtar të revizionit

Subjektet kyçe të përfshira në raportin e revizionit:

Partia politike Bashkimi Demokratik për Integrim

Lënda e revizionit:

Revizion të pasqyrave financiare te Bashkimit Demokratik për Integrim për vitin 2019, së bashku me revizionin e pajtueshmërisë

Qëllimi i revizionit:

Të fitohet bindje e arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë të lira nga gabime në të gjitha aspektet materiale, si dhe a janë aktivitetet dhe transaksionet e reflektuara në to, në përputhje me dispozitat ligjore.

Gjendjet kyçe të identifikuara:

Në raportin e donacioneve për vitin 2019, është raportuar një donacion në artikuj, vlera e së cilës e tejkalon shumën e lejuar ligjërisht; Automjetet të cilat i përdor BDI në bazë të marrëveshjeve të lidhura për përdorimin e automjeteve motorike nuk janë të inventarizuara nga komisioni i inventarizimit, si dhe nuk janë shënuar pasuritë materiale me numrat e inventarit.

Rekomandimet kyçe:

Të respektohen shumat e lejuara ligjërisht për donacione;
Të bëhet inventarizimi i pasurive nga një subjekt tjetër dhe të shënohen pasuritë fikse me numra të inventarit.

Vërejtjet e marra mbi draft Raportin:

Nuk janë marrë vërejtje mbi draft raportin e Revizorit të autorizuar shtetëror.

Opinionin i dhënë*:

Kemi shprehur opinion me rezervë në lidhje me vërtetësinë dhe objektivitetin e pasqyrave financiare, si dhe për pajtueshmërinë me legjislacionin, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

Dobësitë kyçe të sistemit:

Të rishikohen dispozitat ligjore në pjesën e financimit të fushatës zgjedhore me mjete nga llogaria e rregullt; precizim në pjesën e financimit të procesit zgjedhor nga donacionet nga partitë politike, në lidhje me limitet individuale dhe totalë të mjeteve; ndryshime dhe plotësime na aktet ligjore që rregullojnë mënyrën e kontabilitetit të organizatave jofitimprurëse dhe rregullimin e mënyrës së pagesës, pagesës dhe regjistrimit të tarifave për anëtarësim si burim i financimit

Përgjigja ndaj vërejtjeve të marra:

/

*  pozitive,  me rezervë,  i pafavorshëm,  i përmbajtur